



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.581/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 1. *Arte Aplikative në Dizajnimin e Hapësirave të Brendshme, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 110 studentë për vit akademik.*
 2. *Eстетikë dhe Kozmetologji, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik.*
- II. Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 3. *Arkitekturë BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;*
 4. *Marketing dhe Menaxhim Biznesi MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
 5. *Dizajn Grafik MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
 6. *Dizajn Grafik dhe Arte Vizuele, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 140 studentë për vit akademik.*
 7. *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Softuerike, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 275 studentë për vit akademik.*
 8. *Menaxhim Shëndetësor, MSc (120 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
 9. *Teknik i Radiologjisë, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- III. Riakreditohet programi i studimeve të Kolegjit AAB për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):
 10. *Stomatologji, Dr. Dent (360 ECTS) me kuotën maksimumi 45 studentë për vit akademik.*
- IV. Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

- V. Obligohet Kolegji AAB që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Obligohet Kolegji AAB të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Arte Aplikative ne Dizajnimin e Hapësirave te Brendshme, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 110 studentë për vit akademik.</i>	Nora Ahmeti Alan Diba Celina Baymak Hektor Vokshi Bekim Kryeziu
2.	<i>Estetike dhe Kozmetologji, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 75 studentë për vit akademik.</i>	Donjete Ahmetaj Rexha Reihane Bislimi Berisha Violeta Zatriqi Skender Zatriqi
3.	<i>Arkitekturë BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik;</i>	Kaltrina Jashanica Ejup Dullinja Rilind Cocaj Blerim Lutolli
4.	<i>Marketing dhe Menaxhim Biznesi MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.</i>	Ali Ismajli Agron Mustafa Irir Rexhepi Shkumbin Misini
5.	<i>Dizajn Grafik MA (120 ECTS) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.</i>	Luan Tashi Leonita Fazliu Gureta Breznica Bjarami
6.	<i>Dizajn Grafik dhe Arte Vizuele, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 140 studentë për vit akademik.</i>	Liridona Abdullahu Agon Nimani Clirim Vokshi Miran Kozmaqi
7.	<i>Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Softuerike, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 275 studentë për vit akademik.</i>	Jusuf Qarkaxhija Avni Pllana Laurik Helshani Fesal Baxhaku

		Ramadan Dervishi
8.	<i>Menaxhim Shëndetësor, MSc (120 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.</i>	Fatime Qosaj Arenliu Luan Jaha Blerta Haliti Baruti
9.	<i>Teknik i Radiologjisë, BP (180 ECTS) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.</i>	Ilir Bejta Murat Murati Antigone Sadikaj Milaim Kosumi Sehad Kadiri Daut Gorani
10.	<i>Stomatologji, Dr. Dent (360 ECTS) me kuotën maksimumi 45 studentë për vit akademik.</i>	Bleron Azizi Mimoza Selmani Duci Teuta Bicaj Abdyl Shoshi Donika Ilijazi Shahiqi Rajmonda Halili Astrit Kuci Blerim Mehmeti

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Arte Aplikative në Dizajnimin e Hapësirave të Brendshme, BA (180 ECTS)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 13.03.2025 me këtë përbërje: Diana Milcic, Fedja Vukić dhe Shadiyar Tauyekel. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; *Estetike dhe Kozmetologji, BSc (180 ECTS)*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 21.03.2025 me këtë përbërje: Adrian Tudor Stan, Fatos Korkmaz dhe Shadiyar Tauyekel.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

3. **Për programin e studimit; *Arkitekturë BA (180 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 20.02.2025 me këtë përbërje: Philippe Bouillard, Tihomir Dokšanović dhe Arnoldas Solovjovas.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

4. **Për programin e studimit; *Marketing dhe Menaxhim Biznesi MA (120 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 06.03.2025 me këtë përbërje: Dovile Gailiute-Janusone, Johannes Falterbaum dhe Katerina Klimoska.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

5. **Për programin e studimit; *Dizajn Grafik MA (120 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 12.03.2025 me këtë përbërje: Diana Milcic, Fedja Vukić dhe Shadiyar Tauyekel.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

6. **Për programin e studimit; *Dizajn Grafik dhe Arte Vizuele, BA (180 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 12.03.2025 me këtë përbërje: Diana Milcic, Fedja Vukić, Shadiyar dhe Tauyekel. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

7. **Për programin e studimit; *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Softuerike, BSc (180 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 14.03.2025 me këtë përbërje: Ahmad Zargari, Flavio Canavero dhe Laura Palac. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

8. **Për programin e studimit; *Menaxhim Shëndetësor, MSc (120 ECTS)***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 15.04.2025 me këtë përbërje: Anto Cartolovni, Imatullah Akyar dhe Nadia Manzoni. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

9. Për programin e studimit; Teknik i Radiologjise, BP (180 ECTS) vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 15.04.2025 me këtë përbërje: Imatullah Akyar, Anto Cartolovni, Nadia Manzoni. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.

10. Për programin e studimit; Stomatologji, Dr. Dent (360 ECTS)), vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 21.03.2025 me këtë përbërje: Adrian Stan, Fatos Korkmaz, Shadiyar Tauyekel Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë